



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE / MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE / MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE  
Prishtinë / Pristina / Prishtina

## KONTRATA

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëri anë;  
dhe

**N.T.H " Shqiponja" , Adresa: Rr. Xheva dhe Fehmi Lladrovci, Glllogoc** (në vazhdim  
"Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

**Titulli i kontratës: Shërbimet e buffe-së në ndërtesën e MPMS-së, me numër Identifikues:  
MPMS/209/17/038/236**

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë Shërbimet e buffe-së në ndërtesën e MPMS-së, Kafet ( Espresso, makiato e vogël , e madhe , kapucino , nes kafe , qumesht me qokollade ) , Çaj -Filtër (të gjitha llojet), Pije në kanaqe 330 ml. (coca cola , fanta, sprite, biter limon, tonik, shweeps, çaj i ftohtë ), Lëngje frutash paketim qelqi 250 ml. (pjeshkë, mollë , dredhëz, dardhë, ananas , vishnje, portokall ,multivitamin etj), Ujë natyral 0.5 litër, Ujë i gazuar 0.5 litër., Ujë natyral , I gazuar (qelq) 0.25 litër (referuar në specifikacionin tenderik të bashkangjitur me kontratë).

1.2 Kontrata hynë në fuqi nga data: 01.12.2017-01.05.2018. Kontrata ka kohëzgjatje prej 6 muajsh

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi ,por e njejta mund të ndërpritet , në momentin që stafi i MPMS-së transferohet në objektin Aneks ( nga objekti që jemi tani në objektin e ri afer Grandit). Arsyeja, për shkakë që në objektin aneks nuk është përcaktuar hapësirë për buffe. Kontrata ndërpritet me paralajmërim 15 ditë më herët.

1.4 Vendi i dërgimit të shërbimeve do të jetë : Operatori ekonomik do të ofroj shërbime të pijeve të ftofta dhe të nxehta brenda ndërtesës së MPMS-së

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

### Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

### Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 9,700.00€ [nëntë mijë e shtatëqind euro e zero cent ) Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

### Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë Kompania fituese duhet që për porosite e marra nga stafi i MPMS-së të mbajë evidencë të veçantë për shërbimet e kryera dhe në fund të ç'do muaji të dorëzojë faturat përkatëse bashkangjitur me dëshmitë tjera përcjellëse ( kuponë fiskal i nënshkruar nga pranuesi i shërbimeve).

Ofruesi i shërbimeve do të sigurojë dhe instalojë të gjitha pajisjet, inventarin si dhe materialet dhe burimet e nevojshme, të domosdoshme për funksionimin normal të bufesë.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

### Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

### Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti dhe cilësia e produkteve të ofruara duhet të jetë e niveli të lart, e kjo kryesisht ndërlihet me kualitetin e kafesë.

### Neni 7 Garancioni

7.1 7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të shërbimeve .

### Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [ të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë kjo nënkupton se shërbimet duhet të jenë të shpejta, apo menjëherë pas marrjes së porosisë nga cili do zyrtar., Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës,

Operatorit Ekonomik, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykata Ekonomike e Prishtinës në pajtim me ligjin e Kosovës.

#### Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip]<sup>2</sup> në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	MEHDI MALAJ	Emri:	Feti Ibishi
Pozita:	MENAXHER	Pozita:	Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit- MPMS
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	30.11.2017	Data:	30.11.2017
Vula:		Vula:	



<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.